



Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr. 123/350-17527 datë: 28.03.2022
REFERENC-Ë:	07Nr.350-17527, datë: 22.03.2022
PËR/TO:	Drejtoria e Arsimit Suharekë, Remzi Bajselmani–Drejtore i Drejtorisë Nr.Telefonit: [REDACTED]
	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	Drejtore: Visar Kuçi Punoi: Sedat Bytyçi, inxh.dip.ndërt.
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Lejen Ndërtimore



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-17527, datë: 22.03.2022 nga Drejtoria e Arsimit Suharekë, Remzi Bajselmani – Drejtore i Drejtorisë, për Leje Ndërtimore për ndërtimin e Sallës Sportive në SHFMU “Destan Bajraktari” me etazhitet PL+0 në parcelën kadastrale 00631-0, me numër referues të çertifikatës 143/22 datë 14.01.2022, Zona Kadastrale Suharekë, P.Sh Shfrytëzim i Përhershëm Kuvendi Komunal Suharekë. Pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 28 .03.2022

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.123/350-17527

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, neni 8, pika 8.14 përkatësisht 8.14.2, Dispozita të veçanta (dispozita lehtësuese) për rregullimin e tokës ndërtimore të Vendimit për aprovim të taksave administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit për kategorinë e I-rë dhe të II-të, lejes së rrënit dhe tarifën rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës të Kuvendit të Komunës Suharekë: 01-Nr-016-21653, të Dates: 01.12.2015 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008(e qe nuk është në kundërshtim me PZhK-në 2021-2029 sipas Vendimit 01-Nr-016-67691, datë 29.10.2021), kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria e Arsimit Suharekë - Drejtori Remzi Bajselmani, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë :

AKTVENDIM
MBI LEJEN NDËRTIMORE

Kjo leje ndërtimore për :			
Emri:	Drejtoria e Arsimit Suharekë – Drejtori Remzi Bajselmani	Nr. Personal	
Adresa:	Rr. “Brigada 123”	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore : 07Nr.350-17527, datë: 22.03.2022

Emri i Projektit:	PROJEKT KRYESOR “Ndërtimi i Sallës Sportive ShFMU Destan Bajraktari Suharekë”.		
Emri i Projektuesit:	“Archi COD” Suharekë		
Adresa:	Rr.” Remzi Ademi”, Prizren		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI				
Adresa: Rr.” Brigada 123”, SUHAREKË				
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	Përpjesa	Koordinatat e Objektivit-Shenimi(Piketimi)	
Sipas çertifikatës me nr. të lëndes : 143/22 datë 14.01.22, Z.K Suharekë, P.Sh, K.K Suharekë.	00631-0	1: 1000	1 Y 7485201.261	X 4690976.350
			2 Y 7485180.039	X 4690955.100
			3 Y 7485202.675	X 4690932.509
			4 Y 7485223.889	X 4690953.722
			5 Y 7485214.661	X 4690962.950
			6 Y 7485220.274	X 4690968.569
			7 Y 7485212.623	X 4690975.707
			8 Y 7485207.263	X 4690970.348

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt Arsimit- Sallë Sportive ShFMU Destan Bajraktari Suharekë”.			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Gabariti	(33.0m’ x 29.25m’)	Katshmëria:	(PL+0)
Vija rregullative	6.0 m’ nga aksi i segmentit të rrugës për kyqje “Avdyl Kuçi” Suharekë.	Vija ndërtimore	7.0 m’ nga aksi i segmentit të rrugës për kyqje “ Avdyl Kuçi” Suharekë.

Përshkrimi i lejës ndërtimore
Me këtë vendim, parashtruesit të kërkesës Drejtoria e Arsimit Suharekë – drejtor Remzi Bajselmani, për Leje Ndërtimore për ndërtimin e Ndërtimin e Sallës Sportive ShFMU “Destan Bajraktari” Suharekë me etazhitet PL+0 në parcelën kadastrale 006631-0, me numër referues të çertifikatës 143/22 datë 14.01.2022, Zona Kadastrale Suharekë, Pronë Shoqërore Shfrytëzues i Përhershëm Kuvendi Komunal Suharekë. Objektivinë fjalë, do të shfrytëzohet si Objekt –Sallë Sportive e Edukatës Fizike. Lokacioni i objektivit është në kuadër të PZhU-së, 01Nr.5820 datë 05.03.2008, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelën kadastrale 00631-0, është tokë ndërtimore me destinim Hapësirë Publike Shkollë dhe Banim i përzier (e që nuk është në kundërshtim me PZhK-në 2021-2029 sipas Vendimit 01Nr-016-67691, datë 29.10.2021). Objekti ka gabarit (33.0m’ x 29.25m’), me katshmëri (PL+0). Ndërtimi i objektivit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.73/350-3550, datë: 24.02.2022, si dhe projektit kryesor hartuar nga byroja projektuese: “ Archi Cod” Prishtinë. Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe bruto të objektivit 911.05 m². Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.

- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit’
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
 - Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
 - Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
 - Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar s y e t i m

Aplikuesi Drejtoria e Arsimit – Drejtori Remzi Bajselmani, përmes kërkesës 07Nr.350-17527, datë: 22.03.2022, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit edukativo-Arsimor; Sallë Sportive, sipas projektit të bashkangjitur.

Në bazë të nenit 8.14 Dispozitat e veqanta të rregullorës(dispozita lehtësuese) mbi tarifat dhe ngarkesat, nuk do të paguhet taksë në këtë rast konform nenit 8.14.2 për objektet Arsimore, të rregullorës Nr-16-12102 të datës 01.12.2015, andaj edhe ky objekt lirohet nga pagesa e taksës.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.73/350-3550, datë: 24.02.2022.
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.54/23, të datës: 02.03.2022, lëshuar nga NPRM “ ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.66, datë: 03.03.2022.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor–nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09 Nr.610, datë: 09.03.2022.
- Pëlqim me kushte për rregullimin e dokumentacionit teknik nga KEDS, Nr. 257, datë: 23.03.2022.
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri Nr.03/03-32, datë 24.03.2022.
- Koordinatat e objektit të vendosura sipas kushteve ndërtimore nga gjeodetet Komunës së Suharekës.
- Elaboratin për mbrojtje nga Zjarri tri kopje.
- Tri kopje të projektit zbatues.
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë.
- Kopje e dokumentit identifikues.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform PZHU-së 01Nr.5820 datë 05.03.2008, (e që nuk është në kundërshtim me PZhK-në 2021-2029 sipas Vendimit 01Nr-016-67691, datë 29.10.2021), ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vërtetimit i lejes 07Nr.123/350-17527 datë: 28.03.2022

Vendimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës;
Inspektoratit të Komunës;
Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:
Visar KUÇI



Faqe 5 nga 5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 026, Suharekë – Kosovë
Telefon: 029 271 318
www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net